

AKT THEMELIMI I SHOQUERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Edi Family Group” sh.p.k

Ne Tirane, sot me datë 20.01.2024, me cilesine e “ortakut themelues“ : Z.Eduart Boja, madhor me numer karte identiteti I20805059F, me zotesi juridike, madhere, me zotesi jurdike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, kemi vendosur krijimin e shoquerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **“Edi Family Group” shpk**, (me poshte e quajtur “Shoqeria“)

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria **“Edi Family Group” shpk**, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **“Edi Family Group” shpk**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket, te cilet nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaket gëzojne kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Mezez, Zona Kadastrale 2679,Nr.Pasurie 35/138-N4, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Aktivitete te sherbimit te pijeve, Tregti makinash.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10000 lekë , vetem 1 kuote.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht:

Z. Eduart Boja, zoterues i 1 kuote, qe perfaqesojne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlerë te pergjithshme 10 000 lekë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve me te njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organji Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për

çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte z. **Eduart Boja**, madhor me numer karte identiteti I20805059F.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per një afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim i asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person i trete jashtë ortakerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) Administratori ne respekt te dispozitave ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jne te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishmeper te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.
 - f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :
- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë

vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpëra të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjafueshme.

Neni 12
Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 13
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finansiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rrëth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finansiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15
Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "**Edi Family Group**" shpk, u redaktua nga une "ortaket themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
"Edi Family Group" shpk
Eduart BOJA



